



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 15.12.2021

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “I T E. GRUP” sh.p.k, me NUIS K11323001H, me adresë: Rruga Dytesore Autostrada TiraneDures,Km 5, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-10421-11-04-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje ndriçuesha dhe shtylla ndriçimi”, me afat zbatimi 50 (pesëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës, fond limit 9.700.050 (nëntë milion e shtatëqind mijë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 161, datë 08.11.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **“I T E. GRUP” sh.p.k**, me NUIS K11323001H, me adresë: Rruga Dytesore Autostrada Tirane Dures,Km 5, Tiranë dhe me ofertë ekonomike 6.802.800 (gjashtë milion e tetëqind e dy mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.
2. **“IGROUP” sh.p.k**, me NUIS M01406012K, me adresë: Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6/544+2-P dhe me ofertë ekonomike 8.017.000 (tetë milion e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.
3. **“Agim Tushi” p.f**, me NUIS M01802010J, me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, ZK8270, Sheshi Wilson, Kryqëzimi i Rr.Sulejman Delvina dhe Rr.Sami Frasheri, Godina nr.50. 1001, Tiranë dhe me ofertë ekonomike 0 (zero) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“IGROUP”** sh.p.k, me NUIS M01406012K
2. **“Agim Tushi”** p.f, me NUIS M01802010J

Për arsytet e mëposhtme:

“IGROUP” sh.p.k

1.Nuk përmbush pikën 2.3.2 Kapaciteti teknik *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori për mallrat, objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.

2.Nuk përmbush pikën 2.3.3 Kapaciteti teknik *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose/dhe skeda teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi, të shoqëruara me një përktim të noterizuar në gjuhën shqipe, ku të jepen të gjitha karakteristikat teknike të tyre, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike. Paraqitja e shtojcës 5 “Formulari i specifikimeve teknike” si skedë teknike nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, e firmosur dhe vulosur prej tyre do të vlerësohet e pavlefshme.”* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.

3. Nuk përmbush pikën 2.3.4 Kapaciteti teknik *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për të gjitha mallrat objekt prokurimi, në formën e një tablele sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;*

- a. *Emri i kompanisë prodhuese*
- b. *Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike*
- c. *Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli*
- d. *Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese.*

*Nr. Emri i kompanisë prodhuese Emërtimi i katalogut të prodhuesit Nr.i faqes
Numri identifikues i artikullit*

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skeda teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës” pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.

4. Nuk përmbush pikën 2.3.5 Kapaciteti teknik *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë për shtyllat (zëri 14-19 tek tabela e shtojcës 6) dhe për ndriçuesit (zëri 1-13 tek tabela e shtojcës 6), Çertifikatat e Konformitetit (CE). Për shtyllat (zëri 14-19 tek tabela e shtojcës 6) operatori ekonomik duhet të dorëzojë dhe çertifikatën për galvanizimin sipas normave të përcaktuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.

5.Nuk përmbush pikën 2.3.6 Kapaciteti teknik *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë për zërin “Ndriçues rrugor LED 10.000 lumen (Smart)” dhe “Ndriçues dekorativ LED 8000 lumen (Smart)” çertifikatën e konformitetit të kontrollit sipas normave të përcaktuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”si dhe çertifikatat/raportet e testimit për shkallën e mbrojtjes, izolimin dhe bojën e ndriçuesve sipas normave të përcaktuara*

në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.

6.Nuk përmbush pikën 2.3.8 Kapaciteti teknik “Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e materialeve të pasqyruara në tabelën e mëposhtme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s’kualifikim.

Nr.	Përshkrim	Ndriçuesi	Njësia	Sasia
1	Ndriçues rrugor LED	6.300 Lumen	copë	1
2	Ndriçues rrugor LED	7.500 Lumen	copë	1
3	Ndriçues rrugor LED	9.000 Lumen	copë	1
4	Ndriçues rrugor LED	10.000 Lumen (Smart)	copë	1
5	Ndriçues rrugor LED	14.000 Lumen	copë	1
6	Ndriçues rrugor LED	8.000 Lumen (Smart)	copë	1
7	Ndriçues dekorativ	Konik LED 4.600 Lumen	copë	1
8	Ndriçues dekorativ	me mbulesë rrethore LED 5.700 lumen	copë	1
9	Spot tokësor LED	3.200 Lumen	copë	1
10	Prozhektor LED	8.800 Lumen	copë	1
11	Ndriçues shtyllë	3 Degësh	copë	1

pasi OE në datën dhe orën e përcaktuar në DST nuk ka dorëzuar mostrat e mësipërme.

“Agim Tushi” p.f

Operatori ekonomik “Agim Tushi” pf nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “I T E. GRUP” sh.p.k, me NUIS K11323001H, me adresë: Rruga Dytesore Autostrada Tirane Dures,Km 5, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 6.802.800 (gjashtë milion e tetëqind e dy mijë e tetëqind) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferte e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.